



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 256/5 Prot.

Tiranë, më 27.09.2017

V E N D I M

Nr.197, datë 27/09/2017

“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 72, datë 06.04.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 72, datë 06.04.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier,

VËREJ SE:

Me vendimin nr.139, datë 30.12.2015, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil. Bazuar në këtë vendim ka vijuar mbikëqyrja edhe në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier. Ky proces është përmblyllur me Vendimin Nr. 72, datë 06.04.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier dhe

paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

- 1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave të specifikuara më poshtë.*
- 2. Për të rregulluar situatën në lidhje me pozicionin e punës “Sekretar i Përgjithshëm”, në institucionin e prefektit të qarkut, me qëllim sqarimin e rolit të tij në skemën e administrimit të shërbimit civil, njësia përgjegjëse (DAP), duhet të përcaktojë kategorinë e shërbimit civil në të cilën klasifikohet ky pozicion, ose pozicionin e barasvlershëm me të, sipas kategorive dhe klasave të parashikuara në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikën 5, të kreut 2, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar. Ky proces duhet të gjejë pasqyrim edhe në përshkrimin e punës për pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, në institucionin e prefektit.*
- 3. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse (DAP), që të japë zyrtarisht konfirmimin e saj, lidhur me përshkrimet e punës, nëse ato janë të hartuara në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç parashikohet në pikën 19, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.*

Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse (DAP), përshkrimet e punës t'i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për të vijuar procesin me nënshkrimin e tyre në ndarjen përkatëse, siç parashikohet në pikën 18, shkronja “c”, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.

- 4. Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të nenit 108 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, për punonjëset ***** dhe ***** , duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të nxjerra në kuadër të procedurës së deklarimit të statusit të punësimit si dhe akteve të nxjerra në kuadër të ristrukturimit të institucionit të Prefektit të Qarkut Fier, si akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, pasi pozicionet e gjendjes civile, ku këto punonjëse ushtrojnë detyrën e tyre, nuk janë pjesë e shërbimit civil, por janë funksione të deleguara.*

Për ndreqjen e këtyre parregullsive, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, duhet të veprojë si më poshtë:

- *Të anulojë aktin nr. 3326/7, datë 31.10.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, si dhe aktin nr. 1387/14, datë 13.04.2016, “Transferim për shkak të ristrukturimit”, të nxjerra për punonjësen ******, me detyrë “Specialist i Zyrës së Gjendjes Civile”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier (Nënprefektura Lushnjë).*
- *Të anulojë aktin nr. 3326/5, datë 31.10.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, si dhe aktin nr. 1387/13, datë 13.04.2016, “Transferim për shkak të ristrukturimit”, për punonjësen ******, me detyrë “Specialist i zyrës së gjendjes civile”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier.*

5. Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier duhet të veprojë menjëherë duke nxjerrë aktet përkatëse për fillimin e marrëdhënieve financiare për punonjësit:

- ******, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 6789, datë 04.11.2016, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier.*
- ******, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 6790, datë 04.11.2016, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe funksioneve të Deleguara”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier.*
- ******, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 7739, datë 07.12.2016, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier.*
- ******, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 7735, datë 07.12.2016, në pozicionin “Specialist në Sektorin Juridik”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier.*

Më tej, njësia e burimeve njerëzore duhet të kujdeset që të realizojë të gjithë hapat ligjorë që i ngarkon ligji për periudhën e provës, ku përfshihet kryerja e trajnimit në ASPA dhe vënia nën kujdesin e një nëpunësi me përvojë.

6. Njësia përgjegjëse (DAP) dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, në rastin e punonjësit ***, për të cilin periudha e provës duhet të kishte mbaruar në muajin Korrik 2016, duhet të marrin masa për të finalizuar këtë proces, duke ndjekur hapat e mëposhtëm:**

- *Në kuptim të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Kreut VI, pika 2, germa “a”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të mundësojnë kryerjen e trajnimit të detyrueshëm pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.*

- *Pas përfundimit të këtij trajnimi dhe mbi bazën e vlerësimeve të rezultateve në punë, eprori direkt duhet të finalizojë periudhën e provës për këtë punonjës, me nxjerrjen e aktit individual përkatës, sipas përcaktimeve të Kreut VI, të pikës 7 të vendimit të sipërcituar.*
- *Vendimi i eprorit direkt, duhet t'i njoftohet nëpunësit ***** dhe njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.*
- *Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të Kreut VI, pika 13, të aktit normativ të mësipërm, në rastin e vendimit të konfirmimit, duhet të finalizojë këtë proces nëpërmjet nxjerrjes së aktit të deklaramit të statusit të nëpunësit ***** , brenda 10 ditëve, nga data e njoftimit të konfirmimit nga institucioni i Prefektit të Qarkut Fier.*

7. *Njësia e burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur duhet të nxjerrë aktet individuale të ndërprerjes së marrëdhënies së punës për punonjësit ***** dhe *****.*

Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të nenit 111 dhe 113, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, duhet të marrë masa për rregullimin e paligjshmërisë në lidhje me administrimin e shërbimit civil, duke vepruar si më poshtë:

- *Të anulojë aktin nr. 1387/5, datë 13.04.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Transferim i përhershëm për shkak të ristrukturimit”, për punonjësin ***** , me detyrë Përgjegjës i Sektorit të planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier.*
- *Të anulojë aktin nr. 1387/4, datë 13.04.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Transferim i përhershëm për shkak të ristrukturimit”, për punonjësin ***** , me detyrë “Specialist”, në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara, në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier.*

Këto pozicione duhet të shpallen pozicione të lira dhe të plotësohen sipas procedurave të konkurrimit të përcaktuara në nenet 22, 25 dhe 26, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve normative të dala në zbatim të tij.

8. *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 45 ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmëruar nr. 72, datë 06.04.2017, me vendimin nr.149, datë 30.06.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 72, datë 06.04.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e

Prefektit të Qarkut Fier dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, i cili në datën 04.07.2017, u paraqit pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Fier.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier, dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 1347/2 prot., datë 30.06.2017, *“Njoftim për fillimin e verifikimit”*.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore, si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqërues që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit, është materializuar në procesverbalin e datës 05.07.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personi i kontaktit i institucionit të Prefektit të Qarkut Fier.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore, të vëna në dispozicion, rezultoi se:

- Në pikën 2 të vendimit të Komisionerit, njësisë përgjegjëse (DAP) i është lënë detyrë që të përcaktojë kategorinë e shërbimit civil në të cilën klasifikohet pozicioni *“Sekretar i Përgjithshëm”*, në institucionin e prefektit të qarkut ose pozicionin e barasvlershëm me të, sipas kategorive dhe klasave të parashikuara në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe pikën 5, të kreut 2, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar. Në përfundim të verifikimit, rezultoi se nga ana e Departamentit të Administratës Publike, nuk ka ende asnjë reagim.
- Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në pikën 3 të vendimit, ka kërkuar nga Departamenti i Administratës Publike që të konfirmojë nëse përshkrimet e punës janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç përcaktohet në pikën 19, të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*. Në momentin e verifikimit, nga ana e Departamentit të Administratës Publike nuk është shprehur në lidhje me rekomandimin e mësipërm.
- Në pikën 4 të vendimit paralajmërues të Komisionerit, i është kërkuar njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike, që në kuptim të nenit 108 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të nxjerra në kuadër të procedurës së deklarimit të statusit të punësimit dhe transferimit për shkak të ristrukturimit, për punonjësit *****, me detyrë *“Specialiste e Zyrës së Gjendjes Civile”* dhe *****, me detyrë *“Specialist e Zyrës së Gjendjes Civile”*, si akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, pasi pozicionet e punës në zyrën e

gjendjes civile, ku këta punonjës ushtrojnë detyrën e tyre, nuk përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil.

Ashtu sikundër është pasqyruar edhe në procesverbalin e mbajtur në subjekt gjatë procesit të verifikimit, rezulton se Departamenti i Administratës Publike nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për zbatimin e kësaj pike të vendimit të Komisionerit.

- Njësia e burimeve njerëzore të institucionit në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” dhe në zbatim të pikës 5 të vendimit të Komisionerit, ka nxjerrë:
 - Aktin nr. 5, datë 23.03.2017 për fillimin e marrëdhënieve të punës dhe asaj financiare për punonjësen *****, në pozicionin “Specialiste në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara”. Sipas këtij akti fillimi i marrëdhënieve financiare ka filluar në datën 30.03.2017.
 - Shkresën nr. 673, datë 04.07.2017, për rikthim në detyrë të punonjësit *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 7739, datë 07.12.2016, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier (në zbatim të Vendimit nr. 578, datë 24.07.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë).

Aktualisht, duke qenë se periudha e provës nuk ka përfunduar ende për punonjësit e mësipërm, detyrimet e përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, që lidhen me periudhën e provës, do të ndiqen në vijimësi nga ana e Komisionerit.

Për punonjësin *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, me aktin nr. 6790, datë 04.11.2016, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe funksioneve të Deleguara”, Prefekti i Qarkut Fier nuk e ka zbatuar detyrimin për nxjerrjen e aktit për fillimin e marrëdhënies financiare. Punonjësi në fjalë e ka dërguar për zgjidhje këtë mosmarrëveshje administrative në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, konflikt i cili është në fazën e shqyrtimit nga kjo gjykatë. Në këto kushte, referuar nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon se: “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata”, zbatimi i kësaj pike të vendimit nuk mund të ndiqet më tej nga ana e Komisionerit.

Në rastin e punonjëses *****, emëruar nëpunës civile në periudhë prove, me aktin nr. 7735, datë 07.12.2016, në pozicionin “Specialist në Sektorin Juridik”, rezultoi se kërkesën nr. 680, datë 04.07.2017, kjo punonjëse ka dhënë dorëheqjen nga pozicioni i mësipërm.

- Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në pikën 6 të vendimit, ka rekomanduar Departamentin e Administratës Publike, si njësia përgjegjëse për institucionin e Prefektit të Qarkut Fier, dhe njësinë e burimeve njerëzore të institucionit të mundësojnë trajnimin e

detyrueshëm të nëpunësit civil ***** , të cilit i kishte mbaruar periudha e provës që në muajin Korrik 2014, si dhe zbatimin e gjithë procedurës që përcakton neni 24 i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në zbatim të rekomandimit të mësipërm punonjësi ***** ka zhvilluar trajnimin e detyrueshëm pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike për periudhën 18-28 Prill 2017, në përfundim të të cilit është vlerësuar me 23 pikë nga 28 të mundshme. Me shkresën nr. Ekstra, datë 22.05.2017, nëpunësi më i vjetër civil dhe ka bërë vlerësimin për periudhën e provës.

Në vijim, me Vendimin nr. 442/1, datë 25.05.2017, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, Prefekti i Qarkut Fier, në cilësinë e eprorit direkt, pasi ka konstatuar zbatimin e gjithë procedurës së përcaktuar në nenin 24 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka vendosur konfirmimin e punonjësit ***** , “Nëpunës civil” në pozicionin “Specialist në Sektorin Juridik” në Administratën e Prefektit të Qarkut Fier.

Me shkresën nr. 442/2, datë 30.05.2017, vendimi i mësipërm i është njoftuar Departamentit të Administratës Publike dhe punonjësit ***** . Në vijim, DAP, me aktin 3626/3, datë 30.06.2017, ka deklaruar statusin “Nëpunës Civil”, në përfundim të periudhës së provës për punonjësin ***** në pozicionin “Specialist në Sektorin Juridik”, në Administratën e Prefektit të Qarkut Fier.

- Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në pikën 7 të vendimit i ka lënë detyrë Departamentit të Administratës Publike që të anulojë aktin nr. 1387/5, datë 13.04.2016, “Transferim i përhershëm për shkak të ristrukturimit”, për punonjësin ***** , me detyrë “Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier dhe aktin nr. 1387/4, datë 13.04.2016, “Transferim i përhershëm për shkak të ristrukturimit”, për punonjësin ***** , me detyrë “Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier, si akte absolutisht të pavlefshme, të dala në kundërshtim me procedurën e parashikuar në nenin 49 dhe 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në përfundim të verifikimit, rezultoi se Departamenti i Administratës Publike nuk ka vepruar për rregullimin e situatës së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në rastet e sipërpërmendura.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin nr. 72, datë 06.04.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, të Komisionerit, rezultoi se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit janë zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në vendimin paralajmëruar. Aktualisht, pritet reagimi i Departamentit të Administratës Publike në lidhje me:

1. Kategorinë e shërbimit civil në të cilën klasifikohet pozicioni “Sekretar i Përgjithshëm”, në institucionin e prefektit të qarkut ose pozicionin e barasvlershëm me të, detyrë e lënë në pikën 2 të vendimit të Komisionerit.
2. Konfirmimin nëse përshkrimet e punës janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, përcaktuar në pikën 3 të vendimit.
3. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve nr. 3326/7, datë 31.10.2014 “Akti i deklaramit të statusit të punësimit” dhe nr. 1387/14, datë 13.04.2016 “Transferim për shkak të ristrukturimit”, të nxjerra për punonjësen *****, me detyrë “Specialiste e Zyrës së Gjendjes Civile” si dhe aktet nr. 3326/5, datë 31.10.2014 “Akti i deklaramit të statusit të punësimit”, dhe nr. 1387/13, datë 13.04.2016 “Transferim për shkak të ristrukturimit”, për punonjësen *****, me detyrë “Specialiste e zyrës së gjendjes civile”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier (pika 4 e vendimit).
4. Konstatimin e pavlefshëm të akteve nr.1387/5, datë 13.04.2016, “Transferim i përherëshëm për shkak të ristrukturimit”, për punonjësin *****, me detyrë “Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave” dhe nr.1387/4, datë 13.04.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Transferim i përherëshëm për shkak të ristrukturimit”, për punonjësin *****, me detyrë “Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Fier, si akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin, siç është përcaktuar në pikën 7 të vendimit.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit nr. 72, datë 06.04.2017 në institucionin e Prefekturës të Qarkut Fier.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 72, datë 06.04.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.
3. Verifikimin e mëtejshëm të pikave 2, 3, 4 dhe 7 të dispozitivit të Vendimit nr. 160, datë 14.12.2016, për të cilat kërkohet reagimi i Njësisë Përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.

4. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Prefektit të Qarkut Fier, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Punëve të Brendshme dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA